



Prishtinë, 12 shkurt 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1224_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 16 paragrafin 5 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese,
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017 për shoqërinë "2 Korriku" SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, Komuna e Kaçanikut,
- Vendimin V_1108_2019 të datës 28 shkurt 2019 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017 të lëshuar shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_880_2017 të datës 18 janar 2017 për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, të datës 17.01.2019 nr. prot. 036/20 të shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K. me adresë: fshati Soponicë , 71000 Kaçanik, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 12 shkurt 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_880_2017 të datës 18 janar 2017 për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW Komuna e Kaçanikut, edhe për një (1) vit.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 11.11.2014 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.



- Bordi i ZRRE-së, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_766_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 11.01.2017 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 18 janar 2017 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_880_2017 shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, Komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë, 15.01.2019 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali "Soponica", ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 18 janar 2020 për finalizimin e projektit.
- ZRRE me datë, 17.01.2019 nga shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_880_2017 të datës 18 janar 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC "Soponica", ZK Soponicë me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, edhe për një (1) vit.
- *Shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: që nga data e pranimin të vendimit për Autorizim final të Bordit të ZRRE-së, kanë filluar përgatitjet për fillimin e punimeve në ndërtimin e Hidrocentralit HC Soponica, duke filluar me hapja e rrugës, traseja e tubacionit dhe ndërtesa e hidrocentralit.*
- *Shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., në kërkesën e saj po ashtu ka sqaruar se, janë duke punuar intesivisht në teren edhe përkundër vështirësive në realizimin e projektit HC "Soponica", ku deri më tani punët civile janë përfunduar, punimet në hapjen e trasesë së tubacionit janë vendosur/montuar më shumë se 2 km tubacion, është duke u finalizuar vepra e marrjes, i kanë porositur turbinat s'bashku me pjesët përcjellëse teknike dhe teknologjike, ku nga këto mund të sigurojnë se deri më tani janë përfunduar më shumë se 70 % të punimeve.*
- *Shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka sqaruar se vonesat janë shkaktuar për shkak të ndërrimit të veprimtarisë të një parcele nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, ku edhe për këtë arsye kanë pasur ndërprerje të punimeve nga komuna e Kaçanikut, ku pas sigurimet të pëlqimeve të nga*



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Nr. ZSP -419/19, dhe vendimin për ndërrim destinimi nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut 01Nr. 06-351/01-3151/19, kanë siguruar vërtetimin e Drejtorisë Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit 06-104/02-1314/20 me të cilën konfirmohet se hidrocentrali HC Saponica posedon Lejen ndërtimore me nr. 06.Nr.351-41368/16 se ka pasur prolongim të punimeve për arsye të shëndrrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore te vepra e marrjes dhe konfirmim se leja ndërtimore është valide dhe punimet mund të vazhdohen në pajtim me lejen ndërtimore, dhe të gjitha këto kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e këtij projekti deri më tani e për të cilat kërkojnë shtyrje të afatit të vendimit V_880_2017 edhe për një periudhë një(1) vjeçare.

- o *Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria "2 Korriku" SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Nenit 16 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, t'iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_880_2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga hidrocentrali HC "Saponica" edhe për një (1) vit, pasi që vonesat deri më tani kanë ardhur nga faktorët e ndyshëm dhe brenda këtij afati do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të finalizuar projektin.*
- o *Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "2 Korriku"SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Saponica, ZK Doganaj, me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW, komuna e Kaçanikut, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_880_2017 i datës 18 janar 2017, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.*
- II. *Vendimi për lëshimin e Autorizim Final V_880_2017 i datës 18 janar 2017, do të vlen deri me datë **18 janar 2021**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.*
- III. *Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.*
- IV. *Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.*



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, U.D. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Bushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kaçanik,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.